



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
SENATI AKADEMIK, BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2184 prot

Korçë, më 27/12 / 2022

VENDIM

Nr. 635, datë 27.12.2022

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE,  
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE FINANCIARE PËR VITIN AKADEMIK  
2021-2022

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, "Funksionet e Senatit Akademik", pika 1, gërma g, si dhe neni 49, "Funksionet e Bordit të Administrimit në Institucionet e arsimit të lartë", pika 1, gërma h, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pasi diskutuan mbi raportin vjetor të veprimtarisë të institucionit për vitin akademik 2020-2021, të hartuar nga Rektorati i Universitetit si dhe duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", pika 4, në mbledhjen e përbashkët të datës 27.12.2022,

VENDOSËN:

1. Të miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe financiare të vitit akademik 2021-2022, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Alketa Zallëmi



KRYETARI I SENATIT

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello



**ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË  
UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË**

**VITI AKADEMIK 2021-2022**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>2. VENDIMET E SENATIT AKADEMIK 2021-2022 .....</b>	<b>4</b>
<b>3. ANALIZA E VEPRIMTARISË MËSIMORE GJATË VITIT AKADEMIK 2021-2022 .....</b>	<b>6</b>
<i>*Përmbledhje e veprimtarisë së drejtorisë së kurrikulës dhe vlerësimit institucional.....</i>	<i>6</i>
<i>*Analiza e programeve të studimit.....</i>	<i>9</i>
<i>*Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit në raport me nevojat e individëve dhe shoqërisë.....</i>	<i>9</i>
<i>*Ecuria e procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.....</i>	<i>10</i>
<i>*Pranimet e reja, kriteret, kuotat, kapacitetet pritëse.....</i>	<i>13</i>
<i>*Çelja dhe ristrukturimi i programeve të reja të studimit në përmbushje të kërkesave të tregut.....</i>	<i>13</i>
<i>*Qendra për Formimin e Vazhduar.....</i>	<i>14</i>
<i>*Të dhëna për njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (organizimi-përbërja).....</i>	<i>17</i>
<i>*Të dhënat për stafin akademik.....</i>	<i>18</i>
<i>*Të dhënat për studentët.....</i>	<i>19</i>
<i>*Sporti Universitar gjatë vitit kalendarik 2022.....</i>	<i>20</i>
<i>*Pikësynimet e vitit 2021-2022 që lidhen me veprimtarinë mësimore.....</i>	<i>24</i>
<b>4. ANALIZA E VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE .....</b>	<b>25</b>
<i>*Standardizimi i veprimtarisë kërkimore.....</i>	<i>25</i>
<i>*Rritja e veprimtarisë hulumtuese në institucion.....</i>	<i>25</i>
<i>*Rritja e cilësisë së aktivitetit botues të stafit akademik.....</i>	<i>28</i>
<i>*Rritja e aktivitetit dhe përfshirjes studentore në kërkim.....</i>	<i>29</i>
<i>*Nxitja e kërkimit shkencor me bazë kurrikulën, rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mobiliteve .....</i>	<i>30</i>
<i>*Rritja e kapaciteteve të stafit.....</i>	<i>32</i>
<i>*Rritja e ndikimit të ekspertizës së specializuar të UNIKO në rajon në fushat e bujqësisë, ekonomisë, shkencave natyrore dhe shkencave humane në mbështetje të përparësive kombëtare.....</i>	<i>33</i>
<i>*Vënia në efikasitet të plotë e kapaciteteve të strukturës kërkimore në njësitë përkatëse, për të mundësuar shërbime të kualifikuara ndaj të tretëve .....</i>	<i>34</i>
<i>*Ndërkombëtarizimi .....</i>	<i>34</i>
<b>5. ANALIZA E VEPRIMTARISË FINANCIARE GJATË VITIT AKADEMIK 2021 – 2022.....</b>	<b>37</b>
<i>*Të dhëna të përgjithshme të IAL-së (Struktura organizative, njësitë përbërëse, autoritetet drejtuese, etj.).....</i>	<i>37</i>
<i>*Organigrama 2022.....</i>	<i>38</i>
<i>*Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit.....</i>	<i>39</i>
<i>*Realizimi faktik i planit buxhetor paraardhës sipas zërave të buxhetit dhe plani buxhetor i vitit pasardhës, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.....</i>	<i>39</i>

<i>*Dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve tatimore.....</i>	<i>47</i>
<i>*Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik financiar nga IAL.....</i>	<i>48</i>
<i>*Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore.....</i>	<i>49</i>
<b>6. SHTOJCA.....</b>	<b>60</b>

## 1. HYRJE

Si një institucion publik i Arsimit të Lartë në Shqipëri, Universiteti “Fan S. Noli” synon të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme realizimin e misionit të tij. Përbushja e këtij misioni, që ka për qëllim “të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve”, ai synon ta realizojë nëpërmjet mënyrës se si veprimtaria e tij orientohet drejt:

- a) përgatitjes së specialistëve me profesionalizëm të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale;
- b) formimit të shkencëtarëve të rinj në fushat përkatëse, duke marrë parasysh drejtimit kryesorë të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese;
- c) kryerjes së studimeve shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe ofrimin të shërbimeve për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka Rajoni i Korçës dhe më gjerë;
- ç) kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.

Duke qenë se sa më sipër orienton veprimtarinë e përvitshme mësimore, shkencore dhe financiare të këtij institucioni, është e rëndësishme që aktorët e përfshirë në të, të analizojnë drejtimit e aktivitetit të realizuar në kuadër institucional dhe të përcaktojnë drejtimit kryesorë të veprimtarisë për vitin e ardhshëm.

Në këtë kuadër, në zbatim të Nenit 32, pika 1, të Ligjit Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit, nr.5, datë 19.02.18, të MASR “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, Universiteti “Fan S. Noli” kryen analizën e ecurisë së procesit mësimor, kërkimor gjatë vitit akademik 2021-2022 dhe të veprimtarisë financiare 2022. Ai harton raportin e përvitshëm të vlerësimit, i cili paraqet në mënyrë të detajuar drejtimit në të cilat është zhvilluar veprimtaria e njësive dhe sektorëve përbërës të këtij institucioni, që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore të institucionit. Raporti synon të evidentojë drejtimit kryesorë që përfshijnë veprimtarinë e organeve vendimmarrëse hapjen e programeve të reja dhe qëndrueshmërinë e programeve tashmë në funksion, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatshmërinë e rregulloreve të programeve të studimit me kërkesat sa vjen e në rritje të tregut të punës në rajonin e Korçës, ngarkesat mësimore dhe burimet e literaturës, si dhe drejtimit kryesorë të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik të universitetit.

Kjo analizë u përgatit falë kontributit të secilës prej njësive përbërëse të Universitetit, informacioneve të përditësuara të vëna në dispozicion nga personeli ndihmës-mësimor dhe sektorët e administratës së Universitetit. Ajo përmban të dhëna të paraqitura në analizat përkatëse të Fakulteteve dhe synon jo vetëm të evidentojë arritjet e deritanishme në drejtimit e sipërpërmendura, por edhe të nxjerrë në pah dinamikën e Universitetit “Fan S. Noli” në lidhje me përbushjen e kriterëve të Deklaratës së Bolonjës dhe të Standardeve të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë këndvështrim ajo shërben njëkohësisht edhe

si një raport vetëvlerësimi për treguesit e matshëm të cilësisë në këtë institucion dhe masat që duhen marrë në vijim për përmirësimet e nevojshme në këtë kuadër.

## **2. VENDIMET E SENATIT AKADEMIK 2021-2022**

Senati Akademik është organi kolegjal vendimmarrës, i cili përcakton politikat e zhvillimit të Universitetit duke programuar, bashkërenduar, drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Gjatë vitit akademik 2020-2021 Senati Akademik ka vlerësuar efikasitetin e veprimtarive të mësipërme duke nxitur në mënyrë të vazhdueshme sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitet. Ai ka bashkërenduar funksionimin e sektorëve dhe të njësive përbërëse të Universitetit, si dhe ka ditur t'i japë frymë debatit konstruktiv në të mirë të mbarëvajtjes dhe të komunikimit të brendshëm në Universitet.

Senati Akademik për vitin akademik 2021-2022 miratoi çështje të ndryshme në lidhje me:

- Miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin akademik 2020-2021
- Miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023, për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë
- Miratimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit për vitin akademik 2023-2024.
- Ndryshimin e anëtarëve në Komisionin Institucional Zgjedhor, (përfaqësues të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Bujqësisë)
- Miratimin e projektpropozimeve me financim nga të ardhurat e universitetit «Fan S. Noli», viti 2022.
- Miratimin e Rregullores së Buletinit Shkencor.
- Miratimin e Rregullores së Shkëmbimit të Stafit dhe Studentëve, hartuar në kuadër të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit "Fan S. Noli"
- Miratimin e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Etikës të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
- Për dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa", Prof. dr. Artan Hoxhës, Rektor i Universitetit të Tiranës.
- Miratimin e anëtarëve të Bordit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
- Miratimin e kandidatëve për redaktorë të komisionit të botimeve për "Buletinin Shkencor", të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
- Miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit dhe zbatimit të projekteve të financuara nga të ardhurat e universitetit "Fan S. Noli" dhe buxheti i shtetit.
- Miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, zbatimit dhe pagesës së projekteve të financuara nga programet e Bashkimit Europian.
- Miratimin e propozimit për financim të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit "Fan S. Noli", duke filluar nga viti akademik 2022-2023.
- Miratimin e tarifave vjetore të shkollimit për çdo program studimi dhe tarifave për regjistrimin paraprak për vitin akademik 2022-2023.
- Miratimin e ndryshimeve në planet mësimore për vitin akademik 2022-2023.
- Për përcaktimin e masës së shpërblimit të punonjësve të Universitetit.
- Miratimin e programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023-2025.

- Miratimin e Strukturës së vitit akademik 2022-2023.
- Miratimin e formave të diplomave dhe suplementeve të programeve të reja të hapura/riorganizuara të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.
- Për shtyrjen e afatit të kontratave të punës për një pjesë të personelit akademik, kategoria “asistent-lektorë”.
- Vendim Senati për miratimin e kandidaturave që plotësojnë kriteret për Administrator të Universitetit.
- Riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në “Zhvillimi i Integruar Rural”, 60 Ects në Master Profesional në “Drejtim Agrobiznesi”, 60 Ects.
- Ndryshimin e anëtarit në Komisionin Institucional Zgjedhor, përfaqësuesi i studentëve.
- Ndryshimin e anëtarit në Komisionin e Apelimit, përfaqësuesi i studentëve.
- Miratimin e hapjes së programit të studimit “Master i Shkencave” në “Statistikë e Aplikuar”, 120 Ects, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.
- Miratimin e hapjes së programit të studimit “Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi Shqipe dhe Gjuhë Pakicash”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.
- Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit “Master Profesional” në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”, 60 Ects, Fakulteti i Bujqësisë.
- Riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësues për Arsimin e Mesëm Profesional”, në “Master i Shkencave” në “Edukim në Steam”, 120 Ects, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.
- Miratimin e nivelit maksimal të pagave të personelit akademik të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

### 3- ANALIZA E VEPRIMTARISË MËSIMORE GJATË VITIT AKADEMIK 2021-2022

#### **PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË KURRIKULËS DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL**

Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI) është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UK-së dhe është në varësi të rektorit.

Bazuar në udhëzimin e MASR nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe në vendimin e Senatit nr. 694, datë 28.12.2020, “Për miratimin e ndryshimeve në organogramën së Universitetit për vitin 2021” Akademik, u miratua struktura e re organizative e drejtorive dhe sektorëve të UK-së:

- a. *Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA)*
- b. *Sektori i Studimeve (SS)*
- c. *Sektori i TIK (STIK)*

Në fillim të vitit akademik 2021-2022, u hartua plani i veprimtarisë bazuar në përvojën e vitit të kaluar dhe planet e sektorëve në varësi. Përveç veprimtarive të parashikuara nga sektorët, u parashikuan veprimtari të tjera që lidhen kryesisht me:

- Ndjekjen e zbatimit të planit vjetor të veprimtarisë së sektorëve;
- Vlerësimin e performancës së stafit;
- Takime (senat, rektorat, departamente) që lidhen me çështje të mësimdhënies;
- Zbatimi i detyrave të tjera të deleguara nga rektori dhe zv. rektorët.

#### **a- SEKTORI I KURRIKULËS, VLERËSIMIT INSTITUCIONAL DHE ALUMNI**

“Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni”, pjesë e “Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional” ka në përbërjen e tij:

1. Përgjegjës Sektori
2. Specialist për Qendrën e Karrierës dhe Alumni
3. Specialist

Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (më tej SKVIA), e bazon veprimtarinë e tij mbi dy shtylla kryesore:

- 1- Zhvillimin e programeve të studimit dhe procesit mësimor

Zhvillimi i programeve të studimit i referohet gjithë procesit të zhvillimit të programeve që nga procedurat e hapjes, riorganizimit, ndryshimeve në kuadër të përmirësimit të cilësisë e deri te vlerësimi i jashtëm i tyre (procesit të akreditimit).

- 2- Vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë

Sigurimi i cilësisë i referohet respektimit të standardeve të cilësisë në shkallë institucioni dhe programesh studimi. Në këtë kuadër ky sektor menaxhon një rrjet të sigurimit të cilësisë në shkallë IAL-je dhe njësie kryesore në mbështetje të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, si dhe zbatimit ligjor për vlerësimin e jashtëm të IAL-së dhe programeve të studimit.

SKVIA -ja ndjek **sigurimin e cilësisë**, i cili përfshin kryesisht proceset e ndërmarra nga një institucion për arritjen e standardeve.

SKVIA -ja ndjek **kontrollin e cilësisë**, i cili mat rritjen e cilësisë dhe synon ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të përshtatshme për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.



Si i tillë, ai i shërben mirëmenaxhimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe mbarëvajtjes së elementëve, njërive dhe strukturave të tij përbërëse në Universitetin "Fan S. Noli".

**Vlerësimi i cilësisë**, (vlerësimi për akreditim institucional dhe vlerësimi për akreditim të programeve të studimit) realizohet në pesë fusha kryesore:

- Vlerësimi i cilësisë së organizimit dhe menaxhimit të UK-së;
- Vlerësimi i cilësisë së burimeve njerëzore;
- Vlerësimi i kurrikulave;
- Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore;
- Vlerësimi i shërbimeve për studentët.

Për të mbështetur maturantët në fazën e përzgjedhjes së institucionit ku do të kryejnë studimet e larta, studentët në çdo hap gjatë karrierës së tyre akademike dhe studentët alumni në çdo hap gjatë karrierës profesionale, në Universitetin "Fan S. Noli" funksionon Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA- ja tani e në vazhdim). Kjo qendër është ngritur prej nëntorit të vitit 2012. Ajo zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të Universitetit "Fan S. Noli". QKA-ja funksionin si një zyrë që ofron shërbime për maturantët, studentët dhe alumnin.

Veprimtaria e SKVIA u bazua në veprimtaritë kryesore të parashikuara në planin e punës për vitin akademik 2021-2022 të miratuara nga titullarët e UNIKO. Në mënyrë të përmblendhur veprimtaritë u përqendruan kryesisht në:

- përgatitjen e dokumenteve për aplikim për riorganizim dhe hapje programesh të reja studimi;
- përmbushjen e detyrave të procesit të akreditimit të programeve në proces akreditimi;
- përmbushjen e detyrave të procesit të akreditimit periodik të Universitetit "Fan S. Noli";
- aplikime të reja për akreditim të programeve të studimit, plotësim i dokumentacionit;
- zhvillimin e takimeve të NJSBC-së;
- hartimin e relacioneve të ndryshme për vitin akademik 2021-2022;
- përgatitjen e formateve të diplomave dhe suplementeve sipas përcaktimeve të UMAS
- zhvillimin e pyetësorëve të ndryshëm;
- monitorime të ndryshme të procesit mësimor, pranimet e reja, realizimin e ngarkesës, etj.
- kryerjen e njoftimeve për aplikime për mundësi punësim, mundësi për bursa, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, pjesëmarrje në veprimtari online, mundësi për praktika profesionale, njoftime për mbrojtjen e gjuhës së huaj etj.
- përditësimin e dokumentit "pyetjet e shpeshta të studentëve" vendosur në një hapësirë publike në faqen zyrtare të Universitetit për të lehtësuar aksesin dhe informacionin e studentëve me veprimtaritë akademike dhe ndihmës akademike në universitet.
- Mbështetje në gjithë procesin e pranimeve të reja për vitin e ardhshëm akademik

Me vendim të Bordit të Administrimit të Universitetit "Fan S. Noli", nr.143, dt. 16.03.2022, u miratua projekti "Studim i Tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të Universitetit "Fan S. Noli" në përmbushje të kërkesave aktuale të

kualifikimeve”. Në mbështetje të këtij projekti QKA mbështeti gjithë procesin nëpërmjet të dhënave të përgatitura sipas kërkesës nga Instituti për Cilësi në Arsim.

#### **b- SEKTORI I STUDIMEVE DHE SEKTORI I TIK**

- a. SS
- b. STIK

Krahas veprimtarive të përditshme që mbulojnë zgjerimin dhe përdorimin efikas të teknologjisë së informacionit, gjatë këtij viti të dy sektorët punuan në perfeksionimin e proceseve të vendosjes dhe përditësimit të të dhënave në databazën e studentëve dhe përpunimit të tyre në një sistem online digjital dhe në kohë reale. Sistemi digjital i vlerësimit ka ndikuar në mënyrë thelbësore në mirëmenaxhimin e proceseve të sekretarive mësimore, burimeve njerëzore dhe shërbimeve studentore, sepse ka rritur shpejtësinë, transparencën dhe efektivitetin e shërbimit. Gjithashtu, sistemi ka krijuar mundësinë për të gjeneruar në kohë reale dhe saktësisht informacionet statistikore që kërkojnë institucionet shtetërore, si MAS-i, QSHA-ja etj.

#### **Ecuria e Sistemit Digjital të Vlerësimit Pitagora**

- Në fund të muajit dhjetor 2021, menjëherë mbas takimit të Rektorit të Universitetit “Fan S. Noli” me Drejtorin e RASH, filloi puna për vënien në punë të sistemit Pitagora në UNIKO.
- Në fund dhjetori, mbasi RASH kishte kopjuar të dhënat e studentëve përveç notave nga sistemi i mëparshëm ESSE3 në sistemin Pitagora, specialistet e sistemit proceduan me kalueshmërinë e studentëve nga viti akademik 2020-2021 në vit akademik 2021-2022. Në procedurën e kalueshmërisë, kalimi i studentët u bë një nga një duke u bazuar në listat e marra nga sekretariatë mësimore. Vitin e ardhshëm kjo procedurë do të kryhet automatikisht.
- Gjithashtu, në bazë të regjistrimit të marrë nga sekretariatë mësimore:
  - u bë regjistrimi në sistemin Pitagora i të gjithë studentëve të rinj, në të gjitha ciklet e studimit të UNIKO;
  - në muajin janar u procedua me krijimin e kurrikulave në sistemin Pitagora për çdo program studimi për të tre brezat që janë aktivë në vitin akademik aktual;
  - pas konfigurimit të tarifës së shkollimit në sistem nga RASH, u ngarkuan pagesat e tarifës së shkollimit për çdo student në sistem;
- Vonesa në kopjimin e notave nga RASH ka sjellë dhe vonesën në plotësimin e procesverbaleve nga ana pedagogëve, konkretisht:
  - RASH përfundoi kopjimin e notave, pikëve dhe frekuentimeve për Fakultetin e Bujqësisë më datë 4.04.2022 dhe menjëherë filloi plotësimi i procesverbaleve nga pedagogët për këtë fakultet;
  - RASH përfundoi kopjimin e notave, pikëve dhe frekuentimeve për Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë me date 8.04.2022 dhe menjëherë filloi plotësimi i procesverbaleve nga pedagogët për këtë fakultet.
  - RASH përfundoi kopjimin e notave, pikëve dhe frekuentimeve për Fakultetin Ekonomik me date 11.04.2022 dhe menjëherë filloi plotësimi i procesverbaleve nga pedagogët për këtë fakultet.
  - RASH përfundoi kopjimin e notave, pikëve dhe frekuentimeve për Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në 27.04.2022 dhe menjëherë filloi plotësimi i procesverbaleve nga pedagogët për këtë fakultet.

- Të gjitha provimet e sezonit të Verës, sezonit të të mbarturave, sezonit të Vjeshtës dhe sezonit paradiplome ishin gati në sistem përpara datës së provimeve dhe u realizuan me sukses.
- Specialistet e sistemit mbas kontrollit të krediteve për çdo student diplomant realizuan procedurën e diplomimit në sistem duke plotësuar për çdo të diplomuar, nr. diplome, datë diplome, ID mature, datë lëshimi, nr diplome të mëparshëm, matrikull diplomë e mëparshme dhe titulli i tezës së diplomës. Me përfundimin e hedhjes së të dhënave sistemi prodhoi regjistrin e studenteve të diplomuar për printim te kartonit të diplomës.

#### **Pranimet e reja**

- Menaxhimin e regjistrimeve të studentëve të rinj për vitin akademik 2021-2022, nëpërmjet portalit U-Albania.

#### **Infrastruktura**

- Rikonfigurim i rrjetit të internetit, sistemit të telefonisë VOIP në çdo zyrë.
- Vendosja e sistemit të monitorimit me kamera në në godinën e fakultetit të Ekonomisë.
- Për sa i përket infrastrukturës dhe sigurisë në rrjet, sistemi i Universitetit menaxhohet nga një sistem antivirusi, i cili ka rritur në maksimum mundësinë e mbrojtjes nga aplikacione virusesh apo ndërhyrje të paautorizuara në rrjetin universitar.
- Për të mbështetur funksionimin sa më të mirë të internetit u krijua një sistem BACKUP për sistemin e serverave.

#### **❖ ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

Gjatë vitit akademik 2021-2022, Universiteti “Fan S. Noli” ofroi 57 programe studimi<sup>1</sup>, nga të cilat: 7 programe 2-vjeçare me karakter profesional, 25 programe bachelor, 21 programe master profesional, 3 programe master i shkencave dhe 1 program doktrate. Drejtimi kryesor i veprimtarisë mësimore mbetet gjithmonë konsolidimi i programeve ekzistuese, përafrimi i tyre me programet e studimit të rajonit dhe më gjerë, si dhe hapja e programeve të reja, duke synuar kryesisht programet e ciklit të tretë, kjo në bashkëpunim me universitetet partnere ndërkombëtare, me qëllim përshtatshmërinë e programeve të studimit sipas ndryshimeve që sugjerojnë zhvillimet ekonomiko – shoqërore të rajonit.

#### **❖ PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË RAPORT ME NEVOJAT E INDIVIDËVE DHE SHOQËRISË**

##### **➤ Përditësimi dhe miroganzimi i kurrikulave**

Ndryshimet në rregulloret / planet mësimore të programeve të studimit për vitin akademik 2021-2022, u zhvilluan gjatë muajit korrik (01.07.2021) ku secili departament dërgoi pranë SKVIA ndryshimet në rregullore dhe planet mësimore dhe më pas u miratuan nga Senati Akademik. SKVIA hartoi relacionin përkatës të cilin e dorëzoi në Rektorat dhe Senat.

Gjatë gjithë vitit u monitorua procesi mësimor detyrë kjo e përcaktuar edhe në kalendarin e veprimtarisë së DKVI.

Sipas përcaktimeve të UMAS, vijoi puna për regjistrimin e formateve të reja të diplomave dhe suplementeve, pas miratimit në senat, u dërguan modelet e diplomave dhe suplementeve në QSHA për miratim (12.10.2021). Këto format e reja të diplomave dhe

<sup>1</sup> Shtojca 2 – Lista e programeve të studimit për vitin akademik 2021-2022

suplementeve do të përdoren për studentët të cilët diplomohen në vitin akademik 2021-2022 e në vazhdim.

❖ **ECURIA E PROCESIT TË AKREDITIMIT INSTITUCIONAL DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

❖ **Detyra të procesit të akreditimit të programeve të studimit grupi I**

Me përfundimin e gjithë procesit të akreditimit të programeve të studimit të grupit të parë, bazuar në rekomandimet përkatëse në vendimet e akreditimit për çdo program studimi, u hartuan dhe u dërguan në ASCAL (*shkresë nr. 349/1prot., datë 25.02.2022*) planet e veprimit në të cilat u përcaktuan masat, afatet dhe personat përgjegjës lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

❖ **Detyra të procesit të akreditimit të programeve të studimit grupi II**

Dokumentet ku u bazua akreditimi i programeve të studimit:

- Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë
- Manuali “Për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”

Në këtë kuadër u zhvillua dhe përfundoi me sukses procesi i akreditimit për **13** programe studimi, **6** të ciklit të parë “Bachelor”, **4** programe 2-vjeçare të karakterit profesional dhe **3** programe të ciklit të dytë “Master Profesional” si më poshtë:

- “Program Profesional” në “Menaxhim Biznesi Bujqësor”
- “Program Profesional” në “Menaxhim Veterinar”
- “Master Profesional” në “Cilësia dhe Siguria Ushqimore”
- “Master Profesional” në “Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë”
- “Bachelor” në “Gjuhë Letërsi”
- “Bachelor” në “Histori Gjeografi”
- “Program Profesional” në “Asistent Menaxher”
- “Bachelor” në “Administrim Biznesi në Marketing”
- “Master Profesional” në “Financë Kontabilitet”
- “Program Profesional” në “Shërbim Social”
- “Bachelor” në “Matematikë Informatikë”
- “Bachelor” në “Matematikë Fizikë”
- “Bachelor” në “Teknologji Informacioni”

Për të gjitha programet e studimit u ndoqën të gjitha hapat sipas përcaktimeve të akteve në fuqi:

- Në zbatim të procedurave të përcaktuara në agjendat përkatëse, pas njoftimit nga ASCAL u zhvilluan vizitat e ekspertëve në UNIKO për programet e studimit:
  - “Program Profesional” në “Menaxhim Biznesi Bujqësor” (18-19.10.2021)
  - “Program Profesional” në “Menaxhim Veterinar” (18-19.10.2021)
  - “Master Profesional” në “Cilësia dhe Siguria Ushqimore” (18-19.10.2021)
  - “Master Profesional” në “Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë” (18-19.10.2021)
  - “Bachelor” në “Gjuhë Letërsi” (8-9.11.2021)
  - “Bachelor” në “Histori Gjeografi” (8-9.11.2021)
  - “Program Profesional” në “Asistent Menaxher” (8-9.11.2021)
  - “Bachelor” në “Administrim Biznesi në Marketing” (8-9.11.2021)
  - “Master Profesional” në “Financë Kontabilitet” (8-9.11.2021)

- "Program Profesional" në "Shërbim Social" (8-9.11.2021)
- "Bachelor" në "Matematikë Informatikë" (8-9.11.2021)
- "Bachelor" në "Matematikë Fizikë" (8-9.11.2021)
- "Bachelor" në "Teknologji Informacioni" (8-9.11.2021)

Pas vizitave të grupeve të vlerësimit të jashtëm u plotësuan dokumentet shtesë të kërkuara nga ekspertët (28.10.2021, për programet e bujqësisë) (22.11.2021, për programet e tjera) dhe u ndoqën procedurat sipas agjendave.

Në vijim u dërguan drafraportet dhe raportet përfundimtare për çdo program studimi. Pas dërgimit të çdo drafraporti dhe raporti përfundimtar u dërguan komentet përkatëse lidhur me vlerësimin e ekspertëve, si dhe u morën parasysh rekomandimet e lëna si drejtime të punës së njësive bazë.

### ❖ Akreditimi i programeve të studimit grupi III

Puna për akreditimin e programeve të studimit vazhdoi edhe për vitin e ardhshëm akademik, për këtë, u hartua relacioni "*Relacion mbi gjendjen aktuale të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit*", në datën 13.05.2022, në të cilin u përfshinë veprimtaritë, hapat, detyrat e realizuara në kuadër të akreditimit të programeve të studimit, akreditimit institucional. Në këtë dokument u përcaktuan gjithashtu programet e studimit që janë brenda afateve për akreditim. Si rezultat i ngarkesës së lartë, përafrimit të programeve master në fushën e mësuesisë dhe kostos financiare, nuk u aplikua për akreditim programesh studimi brenda afateve të përcaktuara nga ASCAL (31.05.2022). Mbi bazën e planit të veprimit që do të hartohet nga drejtoria do të kryhet aplikimi i programeve që nuk janë akredituar.

#### ▪ Akreditimi institucional

Sipas përcaktimeve të manualit për procedurat dhe afatet për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, para përfundimit të afatit të akreditimit të parë të Universitetit "Fan S. Noli" filloi puna për akreditimin institucional periodik.

Në mënyrë të përmbledhur u ndoqën procedurat:

- Kryerja e aplikimit për akreditimin periodik të Universitetit "Fan S. Noli" (07.12.2021) dhe konfirmimi nga ASCAL;
- Kryerja e mandatpagesës dhe dërgimi për akreditimin periodik të Universitetit "Fan S. Noli" (23.12.2021) dhe konfirmimi nga ASCAL;
- Dërgimi i axhendës së plotë nga ASCAL (07.01.2022)
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe njoftimi i ASCAL (10.02.2022)
- **Faza e vlerësimit të brendshëm**
  - o Hartimi i raportit dhe dosjes shoqëruese në dy gjuhë shqip/anglisht (17.02.2022-01.04.2022);
  - o Ngarkimi i RVV dhe dosjes shoqëruese në sistemin AMS (308 dokumente shqip/anglisht, 5860 faqe dokumentesh shqip/anglisht të printuara, të vulosura dhe të skanuara) (30.03.2022);
  - o Pas dërgimit të materialeve nuk pati nevojë për plotësime dokumentesh.
- **Faza e vlerësimit të jashtëm**
  - o Njoftimi për përbërjen e GVJ;
  - o Njoftimi për datat e vizitave në institucion dhe axhende (26.04.2022)
  - o Zhvillimi i vizitave/takimeve në institucion sipas axhendës së dërguar (9-10.05.2022)

- U kryen njoftimet e pjesëmarrësve në takimet sipas axhendës në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë.
  - U krye koordinimi i takimeve sipas axhendës.
- Pas zhvillimit të takimeve në institucion sipas kërkesës së ekspertëve të jashtëm u dërguan dokumentet shtesë (11.05.2022)
  - U dërgua drafraporti i vlerësimit të jashtëm në AMS (04.07.2022) dhe u dërguan komentet lidhur me vlerësimin e ekspertëve. (07.07.2022)
  - U dërgua raporti i vlerësimit të jashtëm në AMS (18.07.2022) dhe u dërguan komentet lidhur me vlerësimin e ekspertëve. (19.07.2022)

\*Aktualisht procesi i akreditimit periodik të Universitetit “Fan S. Noli” ndodhet në fazën e vlerësimit përfundimtar nga Bordi i Akreditimit.

➤ **Rritja e prurjeve në programet e studimit, promovimi.**

- U krye parapërgatitja për promovimin e Universitetit “Fan S. Noli” duke siguruar kontaktet për këshillimin e karrierës;
- U hartua kalendari me datat e aplikimit Universitar 2021;
- U ofrua mbështetja për informimin dhe plotësimin me e formularit A1Z dhe A2 për maturantët në të gjitha fazat;
- U përditësua manuali për mënyrën e plotësimit të formularit A1Z, për mënyrën sesi plotësohet ky formular në mënyrë të përmbledhur dhe lehtësisht të kuptueshme për ta. Të gjitha këto materiale janë bërë publike në të gjitha faqet e Universitetit “Fan S. Noli”.
- U rishikuan modelet e fletëpalosjeve të viteve të shkuara duke përditësuar të dhënat për prezantimin e ofertës akademike të UNIKO;
- U hartua plani i veprimit për promovimin e UNIKO dhe u përshtat më pas sipas përcaktimeve të shkresës së MAS
- U hartua kalendari i IAL-ve online sipas përcaktimeve të shkresës së MASR;
- U zhvillua promovimi i Universitetit “Fan S. Noli” bazuar në kalendarin e promovimit sipas ZVAP-ve përkatëse.
- U krye promovimi i Universitetit “Fan S. Noli” në mjediset e institucioneve të Arsimit të mesëm. Kalendari i promovimit u përcaktua paraprakisht duke marrë lehtë për lëvizjen e stafit akademik dhe ndihmësakademik, duke përgatitur materialet promovuese si edhe duke kontaktuar me të gjithë drejtorët e institucioneve të arsimit të mesëm;
- U zhvilluan takime dhe veprimtari të shumta me institucione shtetërore/ private, organizata etj., për përfitime të ndryshme për studentët dhe studentët e diplomuar<sup>2</sup>.
- Gjurmimi i studentëve të diplomuar.  
Për vitin akademik 2020-2021 QKA zhvilloi gjurmim e studentëve të diplomuar. Ky proces rezultoi i vështirë për QKA si pasojë e pasaktësive të të dhënave të studentëve të diplomuar.  
Në tabelën e mëposhtme paraqitet gjurmimi i fundit i përditësuar nga QKA për të gjitha programet e studimit<sup>3</sup>:

<sup>2</sup> Më tepër detaje paraqiten në analizën e plotë të QKA.

<sup>3</sup> Shtojca 11 – Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi (burimi i informacionit).

#### ❖ PRANIMET E REJA, KRITERET, KUOTAT, KAPACITETET PRITËSE

Puna për pranimet e reja filloi me publikimin e kriterëve të pranimit dhe miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023 (04.02.2022). Pas publikimit të kriterëve dhe miratimit të kuotave të pranimit, UNIKO u njoftua për kontrollin e kapaciteteve pritëse nga MASR për vitin akademik 2022-2023.

Në zbatim të detyrimeve për deklarimin e kapaciteteve pritëse u deklaruan të gjitha kapacitetet infrastrukturore dhe të dhënat e tjera të kërkuara nga grupi i kontrollit të MAS (29.04.2022). Pas vlerësimit nga MASR, nëpërmjet raportit të kapaciteteve pritëse (19.07.2022), UNIKO u vlerësua pozitivisht duke përmbushur të gjitha standardet për kapacitetet pritëse për vitin akademik 2022-2023.

Sipas përcaktimeve të akteve në fuqi për pranimet e reja dhe urdhrave të përbashkët nga RASH dhe QSHA, SS dhe STIK mbështeti dhe ndoqi gjithë procesin e pranimeve të reja që në momentin e aplikimit.

- Gjatë fazave të regjistrimit u përgatit dokumentacioni për rishpërndarjen e kuotave sipas akteve në fuqi dhe u dërguan në MASR për miratim (07.10.2021).

Në përfundim të pranimeve të reja pati 1129 të regjistruar sipas tabelës së mëposhtme:

Cikli i Studimit	Të rregullt	Program II	Transferuar	Kuota të veçanta të tjera	Shuma
Bachelor	463	3	19	-	487
2- vjeçar PP	189	1	-	-	190
Master (MP+MSC)	450	-	2	6	458
<b>Gjithsej</b>	<b>1102</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>6</b>	<b>1129</b>

- U përgatit dokumentacioni (mandatpagesa për matricullim 14.12.2021) për dërgimin e 1265 studentëve për pajisje me numër matricullimi, u përcollën me shkresë zyrtare në QSHA (23.12.2021. pas dërgimit të dokumentacionit të nevojshëm u miratuan dhe përcollën numrat e matricullimit nga QSHA (17.01.2022)

#### ❖ ÇELJA DHE RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT NË PËRMBUSHJE TË KËRKESAVE TË TREGUT

Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, në bashkëpunim me njësitë bazë filloi puna për përgatitjen e praktikës së aplikimit për programe të reja studimi ose riorganizime.

Sipas përcaktimeve të udhëzimit në fuqi u krye nëpërmjet portalit elektronik e-Albania aplikimi për 3 programe të reja studimi dhe 2 riorganizime si më poshtë:

*Programe të reja studimi:*

"Bachelor" në "Studime kulturore dhe media"

"Master profesional" në "Mësues në edukim fizik, sporte dhe shëndet"

"Master profesional" në "Mësuesi në arsimin gjithëpërfshirës"

*Riorganizime programesh studimi:*

Nga "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin fillor KL. I-VI" në:

“Bachelor” në “Mësuesi për arsimin fillor”  
Nga “Master i Shkencave” në “Filozofi Sociale” në:  
“Master i Shkencave” në “Etika dhe Liderhipi”

Pas përfundimit të fazës së parë u ndoqën procedurat për plotësimin e dokumentacionit për programet që kaluan në fazën e dytë të cilat ishin:

*Programet e reja studimi:*

“Master profesional” në “Mësues në edukim fizik, sporte dhe shëndet”

*Riorganizime programesh studimi:*

“Bachelor” në “Mësuesi për arsimin fillor”

“Master i Shkencave” në “Etika dhe Liderhipi”

Pas kalimit për vlerësim të ekspertëve përkatës u bënë plotësimet e nevojshme dhe u dërguan dokumentet shtesë.

Nga këto programe u riorganizuan për vitin akademik 2022-2023, programet e studimit:

- “Bachelor” në “Mësuesi për arsimin fillor” (UMAS nr. 426, datë 14.07.2022)
- “Master i Shkencave” në “Etika dhe Liderhipi” (UMAS nr. 545, datë 15.09.2022)

U çel programi i ri i studimit:

- “Master profesional” në “Mësues në edukim fizik, sporte dhe shëndet” (UMAS nr. 524, datë 09.09.2022)

#### ➤ STUDIMI INSTITUCIONAL I TREGUT TË PUNËS

Me vendim të Bordit të Administrimit të Universitetit “Fan S. Noli”, nr.143, dt. 16.03.2022, u miratua projekti “Studim i Tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të Universitetit “Fan S. Noli” në përmbushje të kërkesave aktuale të kualifikimeve”. Në mbështetje të këtij projekti QKA mbështeti gjithë procesin nëpërmjet të dhënave të përgatitura sipas kërkesës nga Instituti për Cilësi në Arsim.

#### ❖ QENDRA PËR FORMIMIN E VAZHDUAR

Qendra e Formimit të Vazhduar - UNIKO është një njësi brenda Universitetit “Fan Noli” Korçë që ka për qëllim organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese dhe kualifikuese për mësuesit në shërbim dhe kandidatët për mësues.

Qendra e Formimit të Vazhduar në Universitetin e Korçës ka filluar veprimtarinë e saj në vitin akademik 2013-2014 dhe ka funksionuar me dy Qendra të Ekselencës, përkatësisht në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë dhe në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane të akredituara nga Ministria e Arsimit. Këto dy qendra kanë organizuar trajnimin e mësuesve në shërbim në sesionetë rregullta të shpërndara gjatë vitit në gjithë rajonin e Korçës dhe më gjerë.

Drejtimet kryesore të punës së kësaj qendre përqendrohen në zhvillimin e shprehive të mësimdhënies dhe inovacionit në edukim, në mënyrat dhe praktikat e zhvillimit profesional të mësuesve etj. Fushat kryesore që mbulohen nga modulet e ofruara nga Qendra e Formimit të Vazhduar përfshijnë aspekte të kurrikulës në arsimin parauniversitar, metodologjisë së mësimdhënies, të nxënies dhe vlerësimit, etikës dhe komunikimit, gjithëpërfshirjes në arsim, përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, mentorimit të kandidatëve për mësues, drejtimit të shkollës etj.

Veprimtaria financiare e Qendrës mbështetet në ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe



Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 109, Pika 2, që pasqyrohet në Rregulloren Financiare të Bordit të Administrimit të UNIKO dhe në Vendimin përkatës të Bordit të Administrimit të UNIKO.

Me shpalljen e interesit për trajnime për punonjësit arsimore në arsimin parauniversitar për periudhën **2017-2020**, kjo qendër aplikoi pranë IZHA-s (sot ASCAP) **si një strukturë e vetme në nivel institucional**, me modulet ekzistuese dhe aplikime të reja në përputhje me listën e nevojave për trajnim të evidentuara nga MASR-ja, në maj të vitit 2017.

Me Vendimin **Nr. 26, dt. 19.12.2017** Qendra e Formimit të Vazhduar, Universiteti “Fan S. Noli” akreditohet nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë për një periudhë **4-vjeçare**, deri në dhjetor të vitit **2021**, për të ofruar një gamë të gjerë modulesh trajnimi.

Me **Vendimin nr. 5, datë 03.10.2019** të Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit, në kuadër të Projektit TEAVET, KAPT-i akrediton paketën prej **16 module** për programin. **“Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve TEAVET”**.

Me **Vendimin Nr. 135, dt. 20.05.2022** Qendra e Formimit të Vazhduar akreditohet për një periudhë tjetër 4-vjeçare për të realizuar module trajnimi nga Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit.

Prej **shkurtit të vitit 2018** Qendra për Formimin e Vazhduar zhvillon sesionet e rregullta të trajnimit, bazuar mbi kërkesën e mësuesve të interesuar për zhvillimin e tyre profesional nëpërmjet **portalit të ASCAP-it: [www.trajnime.arsimi.rash.al](http://www.trajnime.arsimi.rash.al)** dhe po nëpërmjet këtij portali edhe bëhet regjistrimi i mësuesve. Risia qëndron në faktin se mësuesve të interesuar, oferta u jepet online.

Portali aksesohet në të njëjtën kohë nga vetë mësuesi që është trajnuar, Qendra e Trajnimit dhe ASCAP-i, duke ruajtur të dhëna për modulën që është trajnuar, periudhën e trajnimit, pikët e fituara dhe certifikimin.

Qendra ka të hedhura në databazë që nga viti 2013 të gjithë të dhënat e mësuesve të trajnuar dhe certifikuar, modulet dhe pedagogët përkatës që kanë kryer trajnimet, periudhën e trajnimit dhe vlerën monetare të paguar prej tyre në llogarinë e universitetit. Një kopje elektronike dhe e printuar e kësaj databaze i dërgohet ASCAP-it edhe MAS-it. Me krijimin e Portalit **[www.trajnime.arsimi.rash.al](http://www.trajnime.arsimi.rash.al)** nga RASH dhe MAS, database emësuesve të trajnuar gjenerohet automatikisht dhe aksesohet nga qendra trajnuese, nga vetëmësuesi dhe nga ASCAP.

Deri në maj të vitit 2022 Qendra e Formimit të Vazhduar UNIKO ka të regjistruar në databazën e saj mbi **5 000** mësues të trajnuar dhe certifikuar pranë saj.

Me mundësitë që ofron sot teknologjia, gjeografia e mësuesve të trajnuar dhe certifikuar pranë kësaj qendre i ka kaluar kufijtë gjeografikë të qarkut të Korçës, duke trajnuar dhe certifikuar mësues nga e gjithë Shqipëria.

Qendra e Formimit të Vazhduar e ka selinë e saj pranë kampusit të ri në Rektoratin e Universitetit “Fan S. Noli” në Katin II. Qendra e Formimit të Vazhduar ka një infrastrukturë moderne për kualifikimin e mësuesve, të pajisur edhe me një bazë të pasur didaktike të teknologjisë bashkëkohore, falë Projektit **TEAVET**, projekt i realizuar në kuadër të Programit **Erasmus +** ku UNIKO është pjesë e tij.

Qendra e Formimit të Vazhduar është pjesë e rrjetit të Qendrave të Formimit të Vazhduar në kuadër të Projektit TEAVET.

Për çdo trajnim të realizuar Qendra e Formimit të Vazhduar lëshon certifikatë për pjesëmarrësit me të gjithë elementët informues mbi modulën ku kanë marrë pjesë. Certifikata ka të gjithë elementët identifikues të Qendrës së Formimit të Vazhduar dhe Universitetit "Fan S. Noli"

Në kuadër të projekteve të përbashkëta, Qendra e Formimit të Vazhduar ka qenë pjesë e një sërë projektesh me produkt hartim dhe zhvillim modulesh në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve si dhe trajnime të mësuesve në shërbim.

Project: TEAVET-Developing Teacher Competencies for a Comprehensive VET System in Albania.

Project No: 586300-EPP-1-2017-ES-EPPKA2-CBHE-SP. Funded by : **Erasmus+Program**, EU Commission 2017-2020. Në bazë të këtij projekti është hartuar edhe një memorandum bashkëpunimi për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxëniet gjatë gjithë jetës midis universiteteve shqiptare<sup>4</sup>.

Për periudhën **2020-2022**, Qendra e Formimit të Vazhduar UNIKO është Koordinator e Rrjetit të Qendrave të Formimit të Vazhduar.

Produkti final i këtij projekti ishte dhe "**TEAVET International Conference**" mbështetur nga Komisioni European në kuadër të Programit Erasmus plus, e cila u mbajt në Vlorë, në datat 10-11 Nëntor 2020. Pjesë e kësaj konference u bënë jo vetëm pedagogë por edhe mësues të trajnuar pranë saj. Botimi i punimeve të kësaj konference u mundësua nga Servicio de Publicaciones, Universidadde León, Spanjë, i cili ishte pjesë e projektit. Mbështetur në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2014-2020 të MASR-së ky projekt kishte si synim një zgjidhje më të mirë për nevojën specifike të ngritjes së kompetencave të mësuesve në shërbim në nivelin e arsimit parauniversitar, duke kërkuar që universitetet shqiptare të kontribuojnë për të ndërtuar një sistem të arsimit dhe aftësisimit profesional me cilësi të lartë për mësuesit, duke u shndërruar në siguresit kryesorë të zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësuesve. Projekti u fokusua në zhvillimin e reformës në profesionin e mësuesit në nivelin e arsimit parauniversitar për trajnimin e mësuesve në shërbim të duke hartuar, zbatuar dhe monitoruar një mësim gjithëpërfshirës për të nxënësit gjatë gjithë jetës (LLL).

- **Projekt bashkëpunimi** me Konsullatën e Përgjithshme të Greqisë në Korçë, Zyra e Koordinatorit për Arsimin, Ministria e Edukimit dhe Çështjeve Fetare, Greqi-për trajnimin e arsimtarëve të shkollave shqiptaro-greke. Në këtë kuadër janë realizuar disa seminare trajnuese online dhe me prani fizike në bashkëpunim me zyrën e koordinatorit të arsimit pranë Konsullatës së përgjithshme greke në Korçë me pjesëmarrjen e autoriteteve drejtuese të UNIKO dhe pedagogëve trajnerë të qendrës. Ky projekt është në vazhdimësi me veprimtari të tjera që do të realizohen në bashkëpunim.

Prej vitit **2021**, Qendra e Formimit të Vazhduar UNIKO është pjesë e **Projektit EntrAL: Aftësi sipërmarrëse për një arsim modern në Shqipëri**, ku Universiteti "Fan S. Noli" është partner në kuadër të Programit Erasmus Plus. Ndër objektivat e këtij projekti synohet edhe shfrytëzimi i qendrave të specializuara të krijuara të

<sup>4</sup> <https://teavet.org/wp-content/uploads/2019/08/agreement.pdf>

trajnimin të mësuesve në përputhje me nevojat e MASR për të rritur mendjen sipërmarrëse në nivel kombëtar përmes trajnimit të akredituar të mësuesve në sipërmarrje, rritjen e mendimit sipërmarrëse në nivel institucional përmes trajnimit të mësuesve dhe kampit të sipërmarrjes, si dhe vendosjen e ekspertizës dhe standardit të ri të trajnimit të mësuesve në sipërmarrjen në universitetet dhe shkollat shqiptare.

#### ❖ TË DHËNA PËR NJËSITË E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (ORGANIZIMI-PËRBËRJA)

NJSBC<sup>5</sup> ka organizuar takime të nevojshme periodike në kuadër të veprimtarive të ndryshme. Fillimisht u përditësua lista me anëtarët e rinj të NJSBC në shkallë fakulteti dhe institucionale bazuar në propozimet e njësive kryesore dhe miratimit nga Senati Akademik.

Sipas parashikimeve në planin e punës së sektorit, u zhvilluan takime të NJSBC-së sipas temave të parashikuara dhe çështjeve të tjera të evidentuara.

Takimi i parë i NJSBC-së u zhvillua në muajin tetor, muaj në të cilin njësia filloi punën për vitin akademik 2021-2022, duke diskutuar çështje që lidhen me planifikimin e punës për këtë vit akademik.

Takimet e tjera të zhvilluara me NJSBC-në gjatë vitit akademik 2021-2022 janë zhvilluar në kuadër të akreditimit të programeve të studimit, fillimin e procesit dhe masat që njësia duhet të ndër marrë si dhe plotësimi i RVB-vë të fakulteteve. Ku janë diskutuar çështje si:

- Hartimit të një plani veprimi lidhur me akreditimin e programeve të studimit
- Planit të punës së veprimtarisë së NJSBC-së
- Raportit përfundimtar të pyetësorit elektronik
- Raportit të vlerësimit paraprak të programeve të studimit
- Plotësimin të RVB-së (2020-2021) dhe problemet që ndeshin anëtarët e njësisë gjatë plotësimin të tij.
- Pyetësorit studentor

#### ▪ Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për secilin fakultet, do të hartohet në mbështetje me formatin e përcaktuar për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit që ofrohen nga secili fakultet. Ky format përmban të gjithë elementët e nevojshëm analitikë. Ai pasqyron rezultatet përmbljedhëse të procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” të Universitetit “Fan S. Noli”, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për vitin akademik 2021-2022. Në analizën SWOT, si pjesë përbërëse e raportit, u evidentuan pikat e forta dhe pikat e dobëta të mundshme si dhe mundësitë dhe rreziqet e jashtme të mundshme.

Raportet për secilin fakultet do të përfundohen në muajin tetor-nëntor 2022, mbi bazën e të dhënave të mara nga këto raporte për të katër fakultetet, SKVIA do të hartojë një relacion përmbljedhës për të gjithë universitetin.

#### ▪ Zhvillimi i pyetësorëve studentorë

<sup>5</sup> Shtojca 4 – Lista e NJSBC

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) e të Bordit të Akreditimit (BA) dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë" i ndryshuar, një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Kjo metodologji është e përhapur në mjaft vende me arsim të lartë të konsoliduar dhe përdoret jo vetëm për këtë qëllim, por për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi apo aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit.

Bazuar në shkresën me nr. 115/4 prot. datë 1.3.2022 "Njoftim mbi zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve", Drejtorja e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, mori të gjitha masat në mbështetje të këtij procesi. ka hartuar planin e veprimit për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar Studentor.

Pas dërgimit të axhendës së takimeve informuese nga ASCAL, . veprimtaritë kryesore që u zhvilluan ishin:

- Ngritja e grupit të punës nga rektori për SKS (07.03.2022)
- Trajnimi i grupit teknik nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) (15.04.2022).
- Zhvillimi i takimit të Përfaqësuesve të ASCAL me studentët e UNIKO (15.04.2022).
- Shpërndarja e pyetësorit nga ASCAL dhe njoftimi i studentëve nga grupi teknik (25 prill deri në 25 maj).

Me hartimin e raportit nga ASCAL (rekomandimet) do të hartohet strategjia për përmirësim pas Sondazhit Kombëtar Studentor nga NJSBC e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.

Pas sezonit të provimeve të verës në muajin korrik 2021 u zhvillua pyetësori studentor nga UNIKO, linku i të cilit u dërgua në adresat elektronike të studentëve, si edhe u shfaq në pjesën hyrëse të platformës PITAGORA, për të lehtësuar aksesin nga studentët si edhe për të rritur numrin e pjesëmarrësve, më pas të dhënat e vjela iu dërguan koordinatorëve të NJSBC në secilin fakultet, të cilët do të dalin me analizën dhe rekomandimet përkatëse.

## ❖ TË DHËNAT PËR STAFIN AKADEMIK

### ▪ Staf i akademik dhe realizimi i mësimin

Një prej standardeve kryesore të vlerësimit të jashtëm të një programi studimi është harmonizimi efektiv mes ngarkesës në mësimdhënie dhe punës kërkimore – shkencore, angazhimeve administrative, shpërndarjes së njohurive, etj.

Kjo lidhet:

- me përcaktimin e ngarkesës e normuar vjetore dhe masën e tejkalimit të saj;
- me shpërndarjen e drejtë të ngarkesës vjetore të dedikuar kërkimit shkencor dhe krijimin e mënyrave të matjes dhe vlerësimit të saj;
- me angazhimin e personelit akademik në veprimtari që lidhen konkretisht me mbështetjen për institucionin dhe angazhime të tjera administrative.

Sipas raporteve të ardhura nga secili fakultet rezulton se ngarkesa e normuar vjetore për vitin akademik 2021-2022 është realizuar kryesisht sipas planifikimit.

Lidhur me realizimin e orëve të stafit akademik në bashkëpunim me njësitë bazë u zhvilluan kontrolle të realizimit të procesit mësimor.

Nga kontrolli i kryer u konstatua se të gjithë pedagogët me kohë të plotë në të gjitha departamentet kanë arritur të realizojnë normën e orëve mësimore në auditor dhe të gjithë edhe e kanë tejkaluar atë duke zhvilluar orë mbi normë.

Përsa u përket regjistrave, ku janë mbajtur shënime orët mësimore në auditor, temat e realizuara, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar etj., kontrolli i tyre është realizuar nga përgjegjësit e njësive bazë përkatëse, sepse një pjesë e orëve janë realizuar online për shkak të pandemisë. Pas këtij kontrolli, nuk u raportua ndonjë problematikë të veçantë.

▪ **Stafi akademik dhe kualifikimi**

Gjatë vitit akademik 2021-2022, stafi akademik<sup>6</sup> u angazhua maksimalisht në kualifikimin duke marrë pjesë në konferenca dhe trajnime në kuadër të rritjes së tyre profesionale.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë kryesore përmenden:

- Raporti staf i brendshëm staf i jashtëm rezulton: 54% PAE/ 46% PAK
- Raporti Staf efektiv/ Student rezulton: 1/20
- Raporti staf i kualifikuar/staf i pakualifikuar PAE rezulton 73% e stafit e kualifikuar dhe 27% e stafit e pakualifikuar.

❖ **TË DHËNAT PËR STUDENTËT**

- Pranimet e reja për vitin akademik 2021-2022<sup>7</sup> pasqyrojnë në përgjithësi një trend rënës krahasuar me vitet e mëparshme. Rëniat vihen re në programet e studimit të fushës së bujqësisë dhe mësuesisë, kjo e fundit edhe si pasojë e rritjes së notës mesatare. Prurje të qëndrueshme tregojnë programet e studimit të departamentit të infermierisë dhe programi i studimit “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte” të cilat i plotësojnë 100% kuotat e parashikuara.
- Të diplomuar gjithsej për Universitetin “Fan S. Noli” **943** studentë.
- Të diplomuar sipas cikleve të programeve:

Të diplomuar programe profesionale 2-vjeçare	145 të diplomuar
Të diplomuar Cikli I Bachelor	403 të diplomuar
Të diplomuar Cikli II Master	395 të diplomuar
Të diplomuar Master Profesional	343 të diplomuar
Të diplomuar Master i Shkencave	52 të diplomuar

- Të diplomuar me notë mesatare mbi 8:

Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	GJITHSEJ
4	40	17	38	98

<sup>6</sup> Shtojca – 9 Lista e plotë e stafit akademik me kohë të plotë PAE dhe stafit akademik me kohë të pjesshme PAK për vitin akademik 2021-2022

<sup>7</sup> Shtojca 5 – Tabela e pranimeve të reja për vitin akademik 2021-2022 (PP/BA/MP/MS)

- Të diplomuar me notë mesatare mbi 9:

Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	GJITHSEJ
1	29	9	20	58

- Studentë të Shkëlqyer

Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	GJITHSEJ
1	4	6	7	18

❖ Studentë me medalje:

- Eralda Tasho, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë;
- Xhuljana Sadikaj, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

▪ **Organizimi dhe përfaqësimi i studentëve**

Këshillat e studentëve promovojnë dhe koordinojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit, si dhe në strukturat mësimore-kërkimore dhe në ato të shërbimeve. Këshilli i Përgjithshëm i Studentëve të Universitetit "Fan S. Noli" dhe Këshilli i Studentëve të çdo Fakulteti zgjidhet me votim nga të gjithë studentët. Ai ka në përbërje të tij përfaqësues të studentëve nga të gjitha fakultetet. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si: për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

Studentët përfaqësohen në organe drejtuese dhe komisione duke i dhënë mundësi për të shprehur mendimin e tyre dhe për të përfaqësuar zërin e studentëve.

❖ **SPORTI UNIVERSITAR GJATË VITIT KALENDARIK 2022**

Universiteti "Fan S. Noli" gjatë vitit kalendarik 2022 ka marrë pjesë në të gjitha kampionatet e organizuara nga Federata e Sportit Universitar të Shqipërisë. Disiplinat në të cilat ka marrë pjesë janë: volejboll femra, basketboll meshkuj, futsall meshkuj, futboll meshkuj dhe femra, tenis femra dhe meshkuj, ping pong, not, handboll meshkuj.

- **Volejboll (femra)**

● **17 Shkurt 2022, Prishtinë**

**Ndeshje miqësore në kuadër të festës së Pavarësisë së Kosovës**

Universiteti "Fan S. Noli" — Universiteti "Hasan Prishtina" Kosovë **0-2**

● **19 Mars 2022**

Ekipi i volejbollit i Universitetit "Fan S. Noli" (mix, femra-meshkuj) morri pjesë në Edicionin e 3-të të turneut "Korça Love Volley", u rendit në vendin e 2-të pas përfundimit të fazës së grupeve, duke u kualifikuar në fazën e dytë të këtij turneu.

● **6-8 Prill 2022, Shkodër**

**Eliminatorët e Kampionatit Kombëtar dhe Kupa Universitare "Luigj Gurakuqi"**

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan **2-0** (ndeshje gjysëmfinale)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër **0-2** (ndeshje finale)

Në këtë kompeticion ekipi i volejbollit të femrave të Universitetit “Fan S. Noli” u kualifikua për në finalet e Kampionatit Universitar dhe zuri vendin e **2-të** në Kupën Universitare “Luigj Gurakuqi”.

● **21-22 Maj , Korçë**

**Kupa Universitare “Fan S. Noli”**

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti i Tiranës **3-0** (ndeshje gjysëmfinale)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti “Hasan Prishtina” Kosovë **3-1** (ndeshje finale)

Në këtë kompeticion ekipi i volejbollit të femrave të Universitetit “Fan S. Noli” doli **kampion**.

● **14-23 Korrik, Lodz, Poloni**

**Lojrat Europiane Universitare 2022**

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti i Venecias, Itali **0-3** (ndeshje për grupin, faza 1)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti Teknologjik i Lodzit, Poloni **2-3** (ndeshje për grupin, faza 1)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti i Beogradit, Sërbi **3-2** (ndeshje për grupin, faza 2)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti Oslos, Norvegji **3-1** (ndeshje për grupin, faza 2)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti i Valencias, Spanjë **2-3** (ndeshje për vendin e 13-të)

Në këtë kompeticion ekipi i volejbollit të femrave të Universitetit “Fan S. Noli” zuri **vendin e 14-të**.

● **5 Dhjetor 2022, Tiranë**

**Kampionati Kombëtar Universitar**

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti Mjekësor i Tiranës **2-0** (ndeshje për 1/6)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti i Sporteve Tiranë **1-2** (ndeshje për 1/3)

Në këtë kompeticion ekipi i volejbollit të femrave të Universitetit “Fan S. Noli” zuri **vendin e 3-të**.

- **Basketboll meshkuj:**

● **6-8 Prill 2022 Shkodër**

**Eliminatoret e Kampionatit Kombëtar dhe Kupa Universitare “Luigj Gurakuqi”**

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër **17-42** (ndeshje finale)

Në këtë kompeticion ekipi i basketbollit i meshkujve të Universitetit “Fan S. Noli” u kualifikua për në finalet e Kampionatit Universitar dhe zuri vendin e **2-të** në Kupën Universitare “Luigj Gurakuqi”.

● **5 Dhjetor 2022, Kampionati Kombëtar Universitar**

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti i Sporteve **25-23** (ndeshje për 1/6)

Universiteti “Fan S. Noli” — Universiteti “Marin Barleti” **15-40** (ndeshje për 1/3)

Në këtë kompeticion Universiteti "Fan S. Noli" zuri **vendin e 3-të**.

- **Futsall meshkuj:**

● **6-8 Prill 2022 Shkodër**

**Eliminatoret e Kampionatit Kombëtar dhe Kupa Universitare "Luigj Gurakuqi"**

Universiteti "Fan S. Noli" — Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër **3-9** (ndeshje eliminatore)

● **8 Dhjetor 2022, Korçë**

**Minikampionat me 6 ekipe (4 ekipeve nga Universitetit "Fan S. Noli" dhe 2 ekipe me të rinj të qytetit të Korçës)**

Këtë aktivitet e zhvilloi Shoqata Studentore Sportive e Universitetit "Fan S. Noli" në bashkëpunim me fondacionin Kenedi Në finale dolën dy ekipe të Universitetit "Fan S. Noli".

- **Futboll meshkuj:**

● **1-4 Qershor 2022, Tiranë**

**Kampionatit Kombëtar Universitar**

Universiteti "Fan S. Noli" — Universiteti i Sporteve Tiranë **2-1** (ndeshje eliminatore);

Universiteti "Fan S. Noli" — Universiteti "Luarasi" Tiranë **4-0** (ndeshje çerekfinale);

Universiteti "Fan S. Noli" — Universiteti "Marin Barleti" Tiranë **1-1** (2-4 penallti) (ndeshje gjysëmfinale).

● **17 Qershor 2022, Kupa Bamirësia**

Shoqata Sportive Studentore e Universitetit "Fan S. Noli" në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Korçë zhvilluan një ndeshje futbollit për bamirësi midis Universitetit "Fan S. Noli" dhe ekipit të futbollit "KF Devolli", në Stadiumin Skënderbeu të Qytetit të Korçës. Të ardhurat nga kjo ndeshje shkuan për MEDPAK (Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara).

Universiteti "Fan S. Noli" — "KF Devolli" **0-1**

- **Futboll femra:**

● **1-4 Qershor 2022, Tiranë**

**Kampionatit Kombëtar Universitar**

Universiteti "Fan S. Noli" — Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër **0-4** (ndeshje çerekfinale)

- **Handboll dhe handbeach meshkuj:**

● **8 Maj 2022, Pogradec**

**Turne për promovimin e Handbollit në shqipëri.**

Federata Shqiptare e Handbollit zhvilloi në këtë ditë në qytetin e Pogradecit një turne me qëllim promovimin e handbollit dhe handbeach. Në këtë turne morrën pjesë ekipet e handbollit e qytetit të Librazhdit dhe Cërrikut, si dhe ekipet e handbollit të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan dhe Universitetit të Tiranës.

Rezultatet e ndeshje të handbollit janë:

Universiteti "Fan S. Noli" — Librazhdi **15-2**

Universiteti "Fan S. Noli" — Durrësi **9-8**

Rezultati i ndeshjes së handbeach është:

Universiteti "Fan S. Noli" — Librazhdi **6-6** (3-4 penallti)

● **18 Dhjetor 2022, Elbasan**

**Kupa Pavarësia**



Në këtë kompeticion pjesëmarrës ishin ekipet e qyteteve të Elbasanit, Cërrikut dhe Fierit, si dhe ekipi i handbollit i universitetit “Fan S. Noli”. Ndeshjet janë:

Universiteti “Fan S. Noli” – Cërriku **13-12** (ndeshje gjysëmfinale)

Universiteti “Fan S. Noli” – Elbasani **12-24** (ndeshje finale)

Në këtë kompeticion ekipi i handbollit i universitetit “Fan S. Noli” zuri vendin e **2-të**.

- **Tenis (meshkuj):**

- **28-31 Mars 2022, Tiranë**

#### **Kampionati Kombëtar Universitar.**

Në këtë kampinat Universiteti “Fan S. Noli” u përfaqësua nga Joan Koti, student i programit të studimit Edukim Fizik dhe Sporte, i cili në përfundim zuri vendin e **2-të**.

- **Not (femra dhe meshkuj):**

- **18-19 Mars, Tiranë**

#### **Kampionati i 2-të Kombëtar Universitar i notit**

Universiteti “Fan S. Noli” morri pjesë me 2 vajza dhe 3 djem dhe bëri një paraqitje dinjitoze në këtë kampionat.

- **Ping Pong (meshkuj):**

- **16-17 Mars, Tiranë**

#### **Kampionati Kombëtar Universitar i Ping Pongut**

Universiteti “Fan S. Noli” morri pjesë me 4 djem dhe bëri një paraqitje dinjitoze në këtë kampionat, duke u kualifikuar deri në çerekfinalet e këtij kampionati.

- **Shah:**

- **18-28 Maj 2022, Korçë**

#### **Kampionati amator “Korça luan shah”**

Kampionati u zhvillua në ambjentët e Qytezës së Fëmijëve dhe në të merrnin pjesë, studentë dhe pedagogë nga Universiteti “Fan S. Noli” si dhe të apasjonuar të këtij sporti nga i gjithë qyteti i Korçës.

- **27 Maj 2022, Korçë**

#### **Simultanë më Zv. Presidenten e Federatës Botërore të Shahut**

Shoqata Sportive Studentore e Universitetit “Fan S. Noli” në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Shahut organizoi një simultanë shahu pranë Qytezës së Fëmijëve, Korçë. Në simultanë morrën pjesë studentë, studentë të alumnit, pedagogë si dhe të apasjonuar të tjerë të këtij sporti. Në simultanë u ndesh Zv. Presidentja e Federatës Botërore të Shahut, Zj. Anastasia Sorokinasi. Gjithashtu, i pranishëm në aktivitet ishte dhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Shahut, Z. Erald Dervishi.

- **21-22 Tetor 2022, Korçë**

#### **Turneu Studentor Universitar Ndërkombëtar i shahut**

Universiteti “Fan S. Noli” organizoi Turneun Studentor Ndërkombëtar të shahut, në të cilin morrën pjesë 24 studentë nga 11 universitete të vendit dhe të rajonit:

Universiteti i “Western Macedonia” Follorinë, Greqi,

Universiteti “St. Klement Ohridski”, Bitola, Maqedoni,

Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë,

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër,

Universiteti i Tiranës,

Universiteti Mjekësor i Tiranës,

Universiteti “Luarasi, Tiranë,

Universiteti Politeknik i Tiranës,

Universiteti "Marin Barleti",  
Universiteti "Polis", Tiranë,  
Universiteti Bujqësor i Tiranës.

❖ **PIKËSYNIMET E VITIT 2021-2022 QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË MËSIMORE**

- Pas marrjes së vendimit të Akreditimit Institucional periodik, përmbushja e rekomandimeve të lëna dhe rritja e cilësisë do të jetë pikësynimi kryesor për vitin në vazhdim, i cili do të përfshijë një sërë veprimtarish dhe angazhim maksimal për të gjithë strukturat e UNIKO.
- Çelja e programeve të reja, përafrimi i programeve ekzistuese, riorganizimi, sipas propozimeve të njësive bazë, si dhe fokusimi në bashkëpunimet ndërinstitucionale për hapjen e programeve të përbashkëta, të dyfishta, apo të shumëfishta në përputhje me kërkesat e MAS për ndërkombëtarizimin.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies së kombinuar duke nxitur përdorimin e platformave mësimdhënëse inovatore dhe shfrytëzimin e plotë të tyre, gjenerimin e formave të mësimdhënies sipas specifika ve të lëndës dhe pasurimin e mekanizmave të angazhimit të studentëve në orët "e kombinuara", si dhe gjetjen e mënyrave më specifike për zhvillimin e orëve të laboratorëve dhe për vlerësimin e studentëve.
- Pajisja e auditorëve me mjete të TIK një auditor të mësimin të kombinuar, i cili do të vihet në dispozicion të mësimdhënies gjatë viteve në vazhdim.
- Rritja sasiore dhe cilësore e prurjeve të studentëve në të gjitha programet dhe krijimi i mekanizmave konkrete të thithjes së maturantëve.

#### 4-ANALIZA E VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE GJATË VITIT AKADEMIK 2021-2022

*Raporti i analizës së veprimtarisë kërkimore-shkencore* për vitin akademik 2021-2022 është hartuar mbi bazën e parashikimeve të detajuara në Planin e strategjik të zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” 2022-2027.

Qëllimi është që paralelisht të vlerësohet ecuria e deritanishme e veprimtarisë në përputhje me objektivat e paracaktuara dhe të detajohet plani kalendarik i veprimtarisë së parashikuar për vitin e ardhshëm kalendarik.

#### ***Mbi realizimin e objektivit I “Rritja e veprimtarisë hulumtuese në njësitë kryesore dhe standardizimi i tij me parimet e etikës së kërkimit”***

➤ *Standardizimi i veprimtarisë kërkimore:*

Gjatë këtij viti u hartuan dhe miratuan disa dokumente të rëndësishëm:

1. “Procedurat për aplikim, miratim, zbatim dhe pagesë për projekte të financuara nga programet e Bashkimit Evropian”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 300, datë 7.7.2022.
2. “Procedura për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e institucionit dhe Buxheti i Shtetit”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 299, datë 7.7.2022.
3. Në këtë kuadër është detajuar kuadri i kërkimit shkencor të Universitetit si një institucion i arsimit të lartë, në Rregulloren e përgjithshme të Universitetit që do të miratohet së shpejti.
4. Është kryer një vlerësim i gjendjes aktuale të laboratorëve, në funksionet bazë të kërkimit dhe shërbimet për palët e treta.

*Gjatë vitit 2022-2023* synohet që, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (e cila së shpejti do të miratohet nga MAS), të vijohet detajimi i:

- Kodit të Etikës së Kërkimit Shkencor dhe hartimi i standarteve të kërkimit shkencor, hartimi i kriterëve të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore të stafit akademik, që lidhet drejtpërdrejt me aplikimin e platformës së kërkimit.

Po ashtu, në përmbyllje të analizës së gjendjes aktuale të laboratorëve në funksion të kërkimit (Shtojca 10- Tabela përmbledhese e laboratorëve), si dhe propozimeve që janë paraqitur nga njësitë bazë, të vijohet me zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga analiza e nevojave të laboratorëve në funksion të kërkimit shkencor dhe shërbimeve për të tretë.

➤ *Rritja e veprimtarisë hulumtuese në institucion:*

Gjatë kësaj periudhe:

- Është rritur ndjeshëm *bashkëpunimi me institucione kërkimore* brenda dhe jashtë vendit duke u nënshkruar gjatë këtij viti me **12** marrëveshje ndërkombëtare dhe **12** marrëveshje kombëtare (Shtojca-1 Lista e marrëveshjeve të nënshkruara 2021-2022). Për çdo marrëveshje të nënshkruar njësisë kryesore u dërgohet një përmbledhje e ofertës akademike të institucionit, në mënyrë që të krijohen mundësi konkrete bashkëpunimi.

Falë këtyre marrëveshjeve është bërë e mundur, rritja e mundësive të shkëmbimeve të stafit dhe studentëve në formën e mobiliteteve mësimdhënëse dhe trajnuese, aplikimi në projekte ndërkombëtare, organizimi i konferencave të përbashkëta dhe botimi i artikujve

të stafit në buletinet përkatëse. Bordi Shkencor i Buletinit Shkencor, po ashtu u ndërkombëtarizua falë këtij bashkëpunimi.

- Universiteti ka tashmë *katër veprimtari shkencore periodike të karakterit ndërkombëtar*:

**Konferenca ndërkombëtare RAEM** "Kërkimi Shkencor, aplikimi dhe metodat në edukim", organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, çdo dy vite akademike.

**Konferenca ndërkombëtare EDUCATION ACROSS BORDERS** organizuar çdo dy vite nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, në bashkëpunim me fakultetet simotra në Universitetin e Bitolës dhe Universitetin e Follorinës.

**Konferenca shkencore ndërkombëtare "Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives"** organizuar nga Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit "Giovanni Maria Bertin", Universiteti i Bolonjës.

**Konferenca Ndërkombëtare "Linguistic Perspectives in the light of social developments"** organizuar nga Departamenti i Gjuhëve të huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.

**Konferenca Studentore** të organizuara rregullisht nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Fakulteti i Ekonomisë.

- Në kuadër të *promovimit akademik*, stafi akademik është angazhuar në konferenca, kongrese, simpoziume në vend dhe jashtë tij (Shtojca 15):

Nr.	EMËRTIMI	FEF	FSHSHSN	FB	FE	Total
1	Kongres	1 autor	1 autor	-	1 autor	3 autorë
2	Konferenca ndërkomb.	77 punime/ 90 autorë	34 punime/ 39 autorë	13 punime/ 13 autorë	20 punime/ 32 autorë	144 punime/ 174 autorë
3	Konferenca kombëtare	16 punime/ 16 autorë	12 punime/ 15 autorë	2 punime/ 2 autorë	-	30 punime/ 33 autorë
4	Simpozium	12 punime/ 13 autorë	2 punime/ 2 autorë	1 punim/ 1 autor	-	15 punime/ 16 autorë
5	Seminare	12 prezantime/ 30 autorë	1 prezantim / 1 anëtar staf	8 prezantime 7 autorë	6 prezantime/ 8 pjesëmarr	27 prezantime 46 autorë
6	Lektorium	1	1 staf	-	2 lektoriume	3 lektoriume

- Universiteti gjatë kësaj periudhe ka rritur *gamën e abonimeve në biblioteka online*: JSTORE -mundësuar nga AADF - <https://www.jstor.org/>
  - EBSCO- mundësuar nga RASH  
Linket e aksesit janë vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve në llogaritë individuale në Sistemin Pitagora.
  - [Home - Springer](http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#) (FREE ACCESS) - <http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#>
  - [Free eBooks | Project Gutenberg](http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#) (FREE ACCESS)- <http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#>
  - [Welcome to Open Library | Open Library](http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#) (FREE ACCESS)- <http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#>
  - [The British Library - The British Library \(bl.uk\)](http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#) (FREE ACCESS)- <http://www.unkorce.edu.al/archive/bibliotekat/shk/index.php#>
- **Gjatë vitit 2023** është parashikuar nisja e punës për *katalogimin e fondit të bibliotekës në sistemin COBISS*, ndërkohë që është shtuar si shërbim *digjitimi i "Fondit Nolian"*. Fondi i Bibliotekës Shkencore është shtuar nëpërmjet *blerjes së librave për Qendrën Ndërdisciplinore të Kërkimit Shkencor*, përkatësisht:
- 33 tituj librash nga autorë të huaj dhe 23 tituj librash nga autorë shqiptarë. Gjatë 2021, Bibliotekës Shkencore i është dhuruar gjithashtu një një fond prej:
    - 363 tituj (rreth 1000 libra) janë dhuruar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë 176 titujsh, kryesisht të fushës së historisë dhe gjuhësisë prej Fondacionit "Alternativa e së Ardhmes" Alsar;
    - 18 librash (5 tituj) i është dhuruar bibliotekës nga Albanian- Amerikan Development Foundation (AADF);
    - 5 titujsh i është dhuruar bibliotekës nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
    - 9 buletine të dhuruara nga Universiteti i Elbasanit; dhe,
    - 7 kopje monografi të dhuruara nga Universiteti i Tiranës. Universiteti "Neofit Rilski", Blagoevgrad, Bullgari i dhuroi bibliotekës shkencore katër vëllime të botimit të tyre "Orbis Linguarium".
- Aktualisht Universiteti ka tenderuar një fond librash të propozuara nga të katërta njësitë kryesore. Nëse procedura mbyllet me sukses, Bibliotekës së Universitetit do t'i shtohen 373 tituj, 4033 kopje.

**Gjatë vitit 2022-2023** synohet,

- përvijimi i marrëveshjeve të realizuara tashmë në drejtimin e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore, aplikimit në projekte të përbashkëta kërkimore, shkëmbime stafi me fokus kërkimin.
- nxitja e mëtejshme e promovimit të gjetjeve të kërkimit të palët e interesit, nëpërmjet promovimit të rezultateve të projekteve institucionale dhe atyre ndërkombëtare- Qendra e Transferimit të Teknologjive (Projekti Erasmus+ TTO4FOOD) dhe Qendra Ndërdisciplinore e Kërkimit Shkencor (Projekt insitucional me fomdet e Buxhetit të Shtetit), duhet të fillojnë aktivitetin e plotë në këtë drejtim.
- riaplikimi i projektit "Digjitalizimi i Fondit të Bibliotekës Shkencore të Universitetit "Fan S. Noli", i cili nuk mundi të realizohet gjatë vitit 2022, me fondet e fituara nga Thirja PIKKSH- AKKSHI.

## **Mbi realizimin e objektivit 2 “Rritja e aktivitetit botues të stafit akademik”**

### ➤ *Rritja e cilësisë së aktivitetit botues të stafit akademik*

Në kuadër të rritjes së aktivitetit dhe cilësisë botuese të stafit akademik gjatë kësaj periudhe është hartuar “Rregullorja e Buletinit Shkencor të Universitetit”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.148, datë 18.3.2022.

Është përditësuar *Bordit Shkencor* i Buletinit Shkencor me vendim të Senatit Akademik nr. 251 datë 31.5.2022, si dhe janë formatuar disa dokumente lidhur me kriteret për botime akademike në rang institucional si: Formulari i recensës, Formati i artikullit për botim në Buletinin Shkencor, Deklarata e autorit.

Janë zgjedhur me vendim të Senatit Akademik nr.252 datë 31.5.2022 redaktorët e *Komisionit të Botimeve*.

Janë miratuar gjithashtu, me vendim të Senatit Akademik nr. 298, datë 7.7.2022 dhe vendim nr. 330, dt. 26.07.2022 të Bordit të Administrimit, *Kriteret dhe procedurat per financimin e botimeve dhe pjesemarrjes ne konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit*, si dhe fondi i cili do të jetë në dispozicion për stafin akademik me kohë të plotë që prej vitit akademik 2022-2023.

Në muajin tetor 2022 doli *botimi në hard copy i Buletinit Shkencor të Universitetit “Fan S. Noli”*, nr. 33, viti i 27-të i botimit (seria e shkencave shoqërore dhe seria e shkencave të zbatuara) me 18 artikuj nga 27 autorë <http://unkorec.edu.al/sites/default/files/P%C3%ABrmbledhje%20e%20abstrakteve%20t%C3%AB%20Buletinit%20Shkencor%20nr.%2033.pdf>,

Tabela përmbledhëse e botimeve të stafit akademik 2021-2022  
(Shtojca 14- Tabela e plotë e botimeve Universiteti 2021-2022)

Nr	EMËRTIMI	FEF	FSHHSHN	FB	FE	Total
1.	Tekste	1	2	-	-	3
2.	Monografi	3	2	-	-	5
3.	Dispensa	1	-	2	-	3
4.	Studime historike	1	-	-	-	1
5.	Artikuj revista shkencore/IF index.	në 21/3	12/3	13/3	2/1	48/10

Në kuadër të konferencave shkencore të organizuara në Universitet u përgatitën dhe dolën në botim:

- Aktet (hardcopy dhe online) të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Politika gjuhësore në Ballkan- Arritje dhe Perspektiva”, organizuar më 12 nëntor 2021 nga departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë në bashkëpunim me departamentin e Gjuhësisë, Universiteti i Tiranës, - në muajin qershor 2022.
- Aktet (online) të Konferencës së Parë dhe të Dytë Shkencore Ndërkombëtare “Research, Application and Educational Methods” RAEM, organizuar në maj 2019 dhe 10-11 shtator 2021, nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane,- në muajin nëntor 2022.
- Aktet (online) e dy Konferencave shkencore ndërkombëtare “Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives”, organizuar në datat 24 qershor

2020 dhe 15 tetor 2021 nga departamenti i Edukimit i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave të Edukimit "Giovanni Maria Bertin" të Universitetit të Bolonjës dhe Programin e Ambasadës Italiane në Shqipëri VALE- Korça, Albania, - në muajin prill 2022.

- Librat e abstrakteve të Konferencës I Shkencore Ndërkombëtare "Linguistic Perspectives in the light of social developments- E-learning approaches to linguistic acquisition", si dhe të Konferencës 18<sup>të</sup> Shkencore Ndërkombëtare "Socio-Economic Challenges in the Post- Pandemic Period", 23-24 shtator 2022, organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë në bashkëpunim me ASECU (Association of Economic Universities of South and Eastern Europe and the Black Sea Region).

**Gjatë vitit 2022-2023** objektivi kryesor është *nxitja e bashkëpunimeve me institucionet partnere për rritjen e bashkëpunimit në kuadër të aktiviteteve shkencore-kërkimore.*

- Përshtatja e kriterëve të publikimit të artikujve në Buletinin Shkencor me qëllim aplikimin e platformes "Open Access". Paraprakisht po merren masat për përshtatjen e dokumentacionit ekzistues të Buletinit në përputhje me kriteret për aplikim për indeksim të botimeve shkencore në DOAJ.
- Përcaktimi i kriterëve vlerësues të botimeve shkencore dhe nxitja e botimeve të indexuara nga stafi akademik i Universitetit.

### ***Mbi realizimin e objektivi i 3 "Përfshirja e studentëve në kërkim"***

#### ***➤ Rritja e aktivitetit dhe përfshirjes studentore në kërkim***

Lidhur me këtë objektivi janë organizuar disa veprimtari shkencore me pjesëmarrjen e studentët si më poshtë:

- Leksion i hapur me studentë të Fakultetit të Bujqësisë, i ftuar prof. as. Dimo Atanasov i Universitetit Bujqësor, Plovdiv, Bullgari;
- Konferencën studentore me temë "Implikimet menaxheriale në modelet e reja të të bërit biznes", organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë në bashkëpunim me Albanian University.
- Konferenca III Studentore me punime të programeve bachelor dhe master, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Universitetit të Kluzhit, Rumani.
- Konferenca studentore me temë "Teknologjia e informacionit dhe komunikimi" me kumtesa të studentëve të ciklit "Master Profesional" në programet e studimeve që Fakulteti i Ekonomisë.
- Sesion shkencor me të ftuar pedagogë e studentë të Departamentit të Histori- Gjeografisë, si dhe pedagogë e studiues të universitetit "Hasan Prishtina", Kosovë dhe Universitetit të Tiranës si bashkorganizatorë të kësaj veprimtarie.
- 8 studentë marrën pjesë në konkursin e punimeve kërkimore-3 "Clean Score" me punimet e tyre kërkimore dhe 3 prej tyre kaluan fazën e parë të pranimin në konkurs.
- Leksione të hapura me studentët e vitit të tretë të programit të studimit histori-gjeografi nga Bucharest Municipality Museum.
- Leksion i hapur "Diabeti, Edukim dhe Parandalim" me student të Departamentit të Infermierisë.
- Leksion i hapur nga Prof.as.dr. Ligia Tomoiagă, profesore e gjuhës angleze pranë Qendrës Universitare Veri Baia Mare të Universitetit Teknik të Kluzhit, me studentët e Departamentit të Gjuhëve të huaja.
- Lektorium me studentët e Departamentit të Agrobiznesit në kuadër të implementimit të projektit "Enhancement of knowledge transfer in the food sector strengthening the technological transfer offices in Albanian universities" TTO4FOOD, në lidhje me krijimin e biznesit në iniciativat e reja në sektorin e Agroushqimit.

- Studentët e vitit III "Bachelor" të programit të studimit Histori- Gjeografi, u angazhuan me kumtesat e tyre, me realizimin e posterave dhe me një dokumentar historik për rrugetimin 110-vjeçar të shtetit shqiptar në Sesionin Shkencor të organizuar nga departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë, në kuadër të 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.
- Në botimin e këtij viti të Buletinint Shkencor, dy prej artikujve ishin me autorësi/bashkëautorësi të alumni.
- Biblioteka shkencore ndërmori gjithashtu një nismë të promovimit të botimeve shkencore që hyjnë periodikisht në të, me anë të analizës studimore të sjellë nga vetë studentët e profileve përkatëse. Nisma filloi me studentët e Departamentit të Shkencave Sociale, për paraqitjen e veprave "Lindja e tragjedisë" nga Niçe dhe "Leksione sociologjike" nga Emil Durkheim.

#### **Gjatë vitit 2022-2023:**

- Një nga objektivat kryesorë përse i përket rritjes së aktivitetit dhe përfshirjes studentore në kërkim është dhe rivitalizimi i Qendrës së Inovacionit.
- Gjithashtu do të fillojë puna për krijimin e databazës së të dhënave për punimet e diplomës së studentëve.
- Botimi elektronik i indeksuar i akteve të konferencave studentore që realizohen në Universitet.

#### **Mbi realizimin e objektivit 4 "Lidhja e kërkimit shkencor me kurrikulën dhe kualifikimet universitare" si dhe objektivit 2 "Programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata" (ndërkombëtarizimi)**

- *Nxitja e kërkimit shkencor me bazë kurrikulën, rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mobiliteteve*

Gjatë këtij viti akademik u realizua aplikimi i programeve të mëposhtme. Ato janë të gjitha nën procedurat e shqyrtimit dhe pritet së shpejti përgjigje nga insitucionet përkatëse:

- Një program i dyfishtë në kuadër projekti Erasmus+ tashmë në proces testimi: *Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi* në bashkëpunim me Universitetin e Nürtingen-Geislingen të Finlandës dhe Universitetin e Shkencave të Aplikuara Savonia, Finlandë
- Një program i përbashkët i ciklit të tretë doktoraturë në "*Studime Etnografike dhe Gjuhësore: fokusi rajoni i Ballkanit*", në bashkëpunim me Universiteti Neoflit Rilski, Bllagoevgrad, Bullgari
- Një program i përbashkët i ciklit të dytë Master në "*Zhvillim i qëndrueshëm i agroturizimit*", në bashkëpunim me Universitetin e Plovdiv, Bullgari.
- Një shkollë e përbashkët verore mes Qendrës Ndërdisciplinore të Studimeve dhe Universitetit të Janinës "*Sfidat dhe perspektivat e gjeneratës në shoqërinë e tekno-informacionit*".
- Një akademi verore e përbashkët mes Qendrës Ndërdisciplinore të Studimeve dhe Universitetit të Aristotelit, Selanik "*Moskopoli: A birthplace of Modernity between Albania and Greece*".
- Pas përfshirjes në organigramën e Universitetit të Qendrës Ndërdisciplinore të Kërkimit Shkencor gjatë kësaj periudhe është bërë e mundur krijimi i një rrjeti me qëndra të ngjashme në rajon me qëllim bashkëpunimin dhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta. Është hartuar dhe miratuar nga Senati Akademik edhe Rregullorja e funksionimit të Qendrës.

Duke u bazuar në planin e punës së projektit për ngritjen e kapaciteteve të qendrës është bërë e mundur blerja e literaturës dhe më tej katalogimi i librave.



- Në kuadër të aplikimit të projektit TeComp- Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences, -Cofunded by Erasmus+ Programme, Universitetit iu vunë në dispozicion dy dokumente të rëndësishëm që lidhen me mësimdhënien: *Strategjia për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në insitucionet e arsimit të lartë*, si dhe *Forcimi i kompetencave të mësimdhënies: Kompetencat dixhitale*.
- Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar me projektin *Clean Score*, stafi akademik është angazhuar në përvetësimin dhe përdorimin e metodave inovative në proceset mësimore dhe pajisjen me një fond të caktuar librash, sipas fuashave dhe programeve të studimit.
- Stafi akademik i UNIKO është në proces aplikimi për programin READ (*Research Expertise from the Academic Diaspora*), i cili u mundëson kërkuesve shqiptarë të bashkëpunojnë me kërkues të tjerë nga Diaspora për të punuar me projekte kërkimore bashkëpunuese me qëllim rritjen e kapaciteteve të institucionit. Ky program gjithashtu mundëson mësimdhënien e përbashkët të shoqëruar edhe nga aktivitete të tjera shkencore. Në thirrjen e radhës u aplikua për 11 projekte kërkimore, në të dy drejtiet e mësipërme.
- Projekti “Nga Gjuha te Veprimi” i financuar nga AUF, synoi rritjen e kompetencës digjitale të programeve online të mësimin të gjuhës së huaj.
- Projekti i financuar nga të ardhurat e Universitetit dhe Buxheti i Shtetit “*Studimi i tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të Universitetit “Fan S. Noli” në përmbushje të kërkesave aktuale të kualifikimeve*”, mundësoi një raport të detajuar të prirjeve të deritanishme dhe prespektivave të zhvillimit të tregut në rajon, me synim përshtatjen e kurrikulave mësimdhënëse dhe profileve akademike.

*Kualifikimi i stafit akademik:*

Staf akademik	Prof.dr.	Prof.as.dr.	Dr.	Doc.	Asistent pedagog	Total
<b>Pedagogë me kohë të plotë</b>	6	27	82	3	36	<b>154</b>
<b>Pedagogë me kohë të pjesshme</b>	16	12	18	1	83	<b>130</b>

*Gradat dhe titujt e fituar vitit akademik tetor 2021- shtator 2022*

Staf akademik	Prof. dr.	Prof. as. dr.	Dr.
<b>Pedagogë me kohë të plotë</b>	1	-	4

**Gjatë vitit 2022-2023** do të vijohet me:

- Konkretizimin e zbatimit të programeve të përbashkëta mësimore/kërkimore të sipërpërmendura.
- Rritjen e kapaciteteve të Qendrës Ndërdisciplinore të Kërkimit. Anëtarët e Qendrës aktualisht janë duke punuar për veprimtaritë që mund të zhvillohen në qendër.
- Nxitjen e mobiliteteve kërkimore mes programeve READ, Marie Sklodowska-Curie Actions, etj.
- Rritjen e kapacitetit të laboratorëve kërkimorë me qëllim vënien e tyre në dispozicion të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

**Mbi realizimin e objektivit 5 “Nxitja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në kërkim të aplikuar” dhe objektivit 3: Kërkimi i përbashkët shkencor sipas standardeve ndërkombëtare (ndërkombëtarizimi)**

➤ *Rritja e kapaciteteve të stafit*

Universiteti ka aktualisht **7 projekte aktive** ndërkombëtare (Shtojca-3 Tabelë përmbledhëse e projekteve Erasmus+), ndërkohë në thirrjen e radhës Erasmus + u aplikua në 12 projekte në cilesinë e partnerit. Në këtë thirrje, Universiteti fitoi dy projekte: *SMART SMART competence centres for the development of innovative and entrepreneurial thinking to increase sustainable smart solutions development in the Western Balkans*, me koordinator Universitetin e Mariborit në Slloveni dhe *PEVULOS Development of an innovative Postgraduate Education programme in Veterinary public health and food Safety in Western Balkan area*, me koordinator Universitetin e Studimeve të Barit.

- Në thirrjet për aplikim për projekte kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit (PKKSH) për vitin 2022, Universiteti është shpallur fitues në projektin me titull "*Evidentimi dhe humlumtimi i Fondit Albanologjik të bibliotekës publike "Thimi Mitko", Korçë*"; ndërkohë që vijon zbatimi i projektit me titull "*Nga projekti drejt të mësuarit në kompetencën dixhitale*".
